



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA  
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM / KANCELARIJA GENERALNOG  
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

**Nr. dokumentit: 21.12.1-2010-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT  
PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË MINISTRISË SË  
ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL PËR VITIN E  
PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2010**

**Prishtinë, Qershor 2011**

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
I. Hyrje .....	5
II. Opinioni i auditimit .....	6
III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara.....	7
IV. Buxheti i Shpenzuar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar .....	8
V. Pasqyrat financiare .....	9
V.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm .....	9
V.2 Cilësia e informatave .....	10
VI. Realizimi i Buxhetit.....	11
VI.1 Shpenzimet.....	11
VI.2 Pasuritë dhe Borxhet .....	13
VII. Kontrolli mbi menaxhimin .....	14
VII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm .....	14
VII.2 Auditimi i Brendshëm.....	15
VIII. Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e MAPL.....	16
Shtojca I. Komentet e MAPL-së dhe përgjigjja e ZAP-it.....	17
Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit.....	17

## **Lista e shkurtesave**

AB	Auditimi i Brendshëm
AP	Auditori i Përgjithshëm
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
KA	Komiteti i Auditimit
LAB	Ligji për Auditimin e Brendshëm
LMFPP	Ligji 03/L-48 për Menaxhimin e Financave dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji nr.02/L-99 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar më 8 shkurt 2007, përfshirë ligjin e ri, nr. 03/L-241 në fuqi prej 01 dhjetor 2010.
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe e Financave
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OE	Operatori Ekonomik
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit(INTOSAI)
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI)
SNK	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS)
UA	Udhëzim Administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZCN	Zyra Civile Ndërkombëtare
ZKA	Zyrtar Kryesor Administrativ

## Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ( MAPL ) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga INTOSAI (ONISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Gjatë formulimit të opinionit ne vlerësuar mjaftueshmërinë e prezantimit të informacionit në pasqyrat financiare.

Sipas opinionit tonë pasqyrat kryesore financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se informacioni i shpalosur mbi pasuritë fikse është jo i plotë dhe i pasaktë. Po ashtu ministria nuk kishte arritur ti shpalos pagesat nga palët e treta.

Shpalosja jo e plotë e pasurive fikse nuk ndikon në opinionin mbi pasqyrat financiare të hartuara në pajtim me SNKSP për kontabilitetin në bazë të parasë së gatshme. (ISSAI 400: *Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes*).

Auditimi ynë ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto dobësi janë të përshkruara më detajisht në brendi të raportit, të cilat duhet të adresohen nga menaxhmenti për të përmirësuar performancën e organizatës.

Për vitin 2009 ishin dhënë 12 rekomandime. Prej tyre gjashte ishin adresuar plotësisht ndërsa gjashtë të tjera janë në proces të adresuar.

*Rekomandimi ynë kryesor* është që Ministri i MAPL duhet të siguroj se janë zhvilluar udhëzime dhe procedura të qarta të cilat duhet të ndihmojnë adresimin e dobësive dhe mangësive të identifikuara në këtë raport.

Ne rekomandojmë që veçanërisht të siguroni:

- Adresimin e të gjitha rekomandimeve të dhëna për vitin 2009;
- Shtimin e kontrolleve të përgjithshme lidhur me planifikimin, monitorimin dhe shfrytëzimin e buxhetit;
- Përgatitjen e pasqyrave financiare në pajtim të plotë me Udhëzimet Administrative dhe rregulloret mbi raportimin vjetor të organizatave buxhetore;
- Forcimin e kontrolleve mbi zhvillimet e prokurimeve përgjatë të gjitha fazave;

- Shtimin e kontrolleve të përgjithshme lidhur me monitorimin dhe shfrytëzimin e subvencioneve;
- Të gjitha pasuritë janë regjistruar në mënyrë të saktë dhe janë shpalosur në pasqyra financiare; dhe
- Fuqizimin e mëtejshëm të auditimit të brendshëm.

Menaxhmentit të Ministrisë i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti.

Menaxhmenti i Ministrisë i ka pranuar të gjitha të gjeturat dhe konkluzionet tona të paraqitura në raportin e auditimit mbi pasqyrat financiare për vitin 2010 dhe është zotuar që do ti bëjë përpjekjet për t'i adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

## **I. Hyrje**

Ky auditim ka të bëjë me Pasqyrat Vjetore Financiare të MAPL për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Është përgjegjësi e MAPL të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ (U/A) 16/2010 dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë për MAPL.

Auditimi i rregullsisë përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi kryer auditimin e ndërmjetëm të MAPL. Gjatë asaj faze të auditimit, kemi adresuar faktin se si janë trajtuar rekomandimet e mëparshme si dhe cilësinë e menaxhimit financiar.

Po ashtu, kemi këshilluar menaxhmentin për adresimin e çështjeve në pasqyra financiare, përmes memorandumit të auditimit të dorëzuar në dhjetor 2010.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave tona për auditimin e MAPL, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar Pasqyrat Vjetore Financiare të MAPL në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2010;
- Kemi përcaktuar nëse Pasqyrat Vjetore Financiare janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer teste substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
- Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në MAPL.

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi Pasqyrat Vjetore Financiare 2010.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të MAPL, standardet ndërkombëtare të auditimit përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 2.

## **II. Opinioni i auditimit**

Sipas opinionit tonë pasqyrat kryesore financiare *në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë.*

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se informacioni i shpalosur mbi pasuritë fikse është jo i plotë dhe i pasaktë. Po ashtu ministria nuk kishte arritur ti shpalos pagesat nga palët e treta.

Shpalosja jo e plotë e pasurive fikse nuk ndikon në opinionin mbi pasqyrat financiare të hartuara në pajtim me SNKSP për kontabilitetin në bazë të parasë së gatshme. (*ISSAI 400: Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes*).

### **III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara**

Në raportin tonë të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të vitit 2009 ishin dhënë dymbëdhjetë rekomandime. Prej këtyre rekomandimeve, gjashtë janë adresuar plotësisht ndërsa të tjera janë në proces të implementimit. Rekomandimet e adresuar janë: Kontrata e të punësuarve janë të nënshkruar nga menaxheri i personelit, pranimi i mallrave bëhet nga personi i autorizuar, prokurimet janë bërë në bazë të planit të prokurimit, të gjitha projektet e investimeve kapitale që ka financuar MAPL në bashkëfinancim me komunat janë bartur si pasuri në Komunat përkatëse, pagesa e tatimit në burim dhe themelimi i komitetit të Auditimit.

Rekomandimet në proces janë:

- Respektimi i të gjitha kërkesat që dalin nga U/A në fund vitit për përgatitjen e pasqyrave financiare;
- Shtimi i kontroleve të përgjithshme lidhur me planifikimin, monitorimin dhe shfrytëzimin e buxhetit;
- Zhvillimi i procedurave të prokurimit në përputhje me ligjet e aplikueshme;
- Menaxhimi i subvencioneve;
- Regjistrimi i pasurisë jo financiare, siç kërkohet me UA Nr. 21/2009; dhe
- Njësia e Auditimit të brendshëm të jetë më funksionale.

Mos adresimi i plotë i rekomandimeve tona, ka shkaktuar të njëjtat probleme si në vitet e kaluara. Me këtë rast, ne shprehim shqetësimin tonë për të gjitha rekomandimet e pa adresuara.

## IV. Buxheti i Shpenzuar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Shpenzimeve në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

**Tabela 1: Përshkrimi i buxheteve dhe shpenzimeve**

Në euro (€)

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Rishikuar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar 2010	Buxheti I shpenzuar 2009
Grandi i Qeverisë – Buxheti	10,257,499	9,517,664	9,476,026	8,239,812	10,479,062
Donacionet e vendit	-	-	-	-	-
Donacionet e jashtme	-	65,846	65,846	65,846	-
<b>I. Gjithsej të hyrat dhe transferi i donacioneve</b>	<b>10,257,499</b>	<b>9,583,510</b>	<b>9,541,872</b>	<b>8,305,658</b>	<b>10,479,062</b>
Pagat dhe mëditje	439,553	680,123	618,301	610,831	526,452
Mallra dhe shërbime	499,857	699,969	813,805	749,073	538,559
Shpenzimet komunale	30,000	48,435	48,435	33,642	24,539
Subvencionet dhe transferet	437,249	437,249	437,249	391,406	435,400
Investimet Kapitale	6,583,852	6,566,805	7,620,511	6,520,706	8,954,112
Rezervat-nga Fondi Kontingjent	2,266,988	1,150,929	3,571	0	0
<b>II. Gjithsej shpenzime</b>	<b>10,257,499</b>	<b>9,583,510</b>	<b>9,541,872</b>	<b>8,305,658</b>	<b>10,479,062</b>

Gjatë vitit 2010 MAPL ka shpenzuar 8,305,658€ apo 87% nga buxheti final. Krahasuar me vitin 2009, shpenzimet e përgjithshme të MAPL kanë rënie për 21%. Arsyeja e këtij dallimi është zvogëlimi i ndarjes buxhetore nga fondi kontingjent.

Me ndarjen buxhetore të vitit 2010, në programin Shpenzime kontingjente, janë ndarë mjete në shumë prej 2,266,988€ Këto mjete janë ndarë për MAPL me qëllim të mbështetjes financiare në krijimin e komunave të reja (Graçanicës, Klllokotit, Parteshit, Ranillugut), si dhe për investime kapitale në këto komuna. Alokimi i mjeteve nga kjo kategori është bërë me pëlqimin e Zyrës Civile Ndërkombëtare (ZCN).

MAPL-së me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 02/150 të datës 23.12.2010 i merren 752,674€ nga programi i shpenzimeve kontingjente për komunat e reja dhe 7,987€ nga kategoria e shpenzimeve kapitale i janë transferuar MASHT, për projektin “Blerja librave” (teksteve) shkollore nga klasa 1-9.



Ne kemi vërejtur tendencën e rritjes së shpenzimeve të investimeve kapitale në fund të vitit financiar, 58% nga shpenzimet e përgjithshme të kësaj kategorie kanë ndodhur në tre muajt e fundit. Niveli i lartë i shpenzimeve për investime kapitale për tre muajt e fundit tregon se ekzistojnë dobësi në proceset e planifikimit, menaxhimit dhe realizimit të buxhetit.

### **Konkluzioni**

Sipas vlerësimit tonë MAPL nuk ka shpenzuar në mënyrë efektive buxhetin e përgjithshëm për vitin 2010.

Në të njëjtën kohë, shpenzimi i buxhetit për investime kapitale prej 58% vetëm në tremujorin e fundit, bart në vete rrezikun se mund të jenë kryer pagesa jashtë kontrolleve të duhura. Kjo është pasojë e dështimeve në zhvillimet me kohë të prokurimeve.

### **Rekomandimi 1**

Rekomandojmë Ministrin e MAPL që të siguroj:

- Shtimin e kontrolleve të përgjithshme lidhur me planifikimin, monitorimin dhe shfrytëzimin e buxhetit. Veçanërisht, përmirësimet duhet fokusuar tek planifikimi i rrjedhës së parasë dhe alokimi i shpenzimeve të bëhet sipas tremujorëve; dhe
- Se planifikimi i proceseve të prokurimeve do të përmirësohet në aspektin kohor.

## **V. Pasqyrat financiare**

### **V.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm**

Bazuar në kërkesat e LMFPP nr. 03/L-048 dhe Udhëzimit Administrativ 16/2010, ne kemi identifikuar pikat në vijim:

- Ministria ka arritur të përgatis P/F sipas UA nr. 16/2010 mbi raportimin vjetor të organizatave buxhetore, përveç shpalosjeve të pasurive dhe pagesave nga palët e treta;
- P/F janë përgatitur në pajtim me SNKSP "Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme";
- P/F janë nënshkruar me 31.01. 2011 nga Zyrtari kryesor administrative dhe zyrtari kryesor financiar;
- P/F janë dorëzuar në MEF/Thesar në datën 6 Prill 2011, pas afatit të paraparë, për shkak të ndryshimeve, në nenin 10 të P/F
- P/F janë përgatit vetëm në gjuhën shqipe; dhe

- Nuk janë dorëzuar raporte financiare tremujore tek Ministri i MEF-it gjatë vitit 2010.

## V.2 Cilësia e informatave

Pasqyrat Financiare të MAPL të përgatitura më 31.01.2011 për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010, nuk ishin në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr.16/2010. Ato përmbanin gabime materiale dhe ishin të pasakta, prandaj ne gjatë procesit të auditimit kemi kërkuar nga MAPL që pasqyrat financiare të versionit fillestar të korrigjohen.

Pasqyrat financiare të MAPL pas kërkesës sonë, gjatë procesit të auditimit, janë korrigjuar dhe dërguar për herë të dytë në Thesar, mirëpo prapë disa gabime kanë mbetur të pa korrigjuara.

Pasaktësitë në vijim nuk janë korrigjuar nga ana e Menaxhmentit:

- Nuk janë shpalosur pagesat nga palët e treta ( 65,846€);dhe
- Shënimi 27, Përmbledhja e pasurive jo financiare në pasqyra financiare nuk është plotësuar sipas U/A 16/2010.

### **Konkluzioni**

Mos shpalosja e pagesave nga palët e treta dhe pasurive në pasqyrat financiare i bën këto pasqyra më pakë të përdorshme.

### **Rekomandimi 2**

Rekomandojmë Ministrin e MAPL që të siguroj se:

- Me rastin e përgatitjes së pasqyrave financiare, janë përfillë të gjitha kërkesat që dalin nga U/A dhe kërkesat tjera ligjore mbi raportimin e jashtëm.

## VI. Realizimi i Buxhetit

### VI.1 Shpenzimet

#### 1.1 Blerjet përmes prokurimit

Ne kemi testuar 69 mostra që mbulojnë 4,579,969€ të pagesave të shpenzimeve të udhëhequra përmes procedurave të prokurimit. Ne kemi vërejtur se Ministria ka ndërmarrë procedurat e prokurimit të cilat nuk janë në pajtim me Ligjin mbi Prokurimin Publik:

#### Pagesat për investime kapitale nga kategoria e subvencioneve

Gjatë auditimit kemi konstatuar se për projektet kapitale „Ndërtimi i kanalizimit të fshatit Dardhishtë”, në vlerë prej 11,448€ pagesa është bërë nga kodi i kategorisë së subvencioneve. Nuk është bërë transferimi i mjeteve nga kategoria e subvencioneve në kategorinë e investimeve kapitale për kompensim.

#### Regjistrimi i shpenzimeve në kode jo adekuate

Tek kontrata “Furnizim me dru për kategoritë e rrezikuara sociale në lagjen multietnike në pjesën urbane të qytetit – Mitrovicë” në vlerë 30,000€ pagesa është regjistruar në kodin e shpenzimeve kapitale, e jo në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

#### **Konkluzion**

Regjistrimi i shpenzimeve në kode të gabuara, pasqyron gjendje jo të drejt të shpenzimeve.

#### **Rekomandimi 3**

Rekomandojmë Ministrin e MAPL që të siguroj se:

- Për çdo ndërrim të destinimit të mjeteve, paraprakisht të sigurohen aprovimet e nevojshme , e pastaj të procedohet edhe me ndërrimin e kodit ekonomik.

#### 1.2 Blerjet tjera

#### Tejkalim të limitit të përcaktuar për shpenzimet e telefonisë fikse

Ne kemi rishikuar shpenzimet e telefonit fiks për tre muaj, dhe kemi vërejtur tejkalim të shpenzimeve nga limitet e përcaktuara sipas U/A nr. 04/2008 mbi përdorimin e telefonave në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Kemi vërejtur se shpenzimet për telefoni fikse për vitin 2010, disa zyrtar kishin tejkaluar kufijtë e përcaktuar për shfrytëzimin e tyre edhe përkundër hapave të ndërmarrë nga menaxhmenti,

## **Konkluzioni**

MAPL nuk ka kontrolle të përshtatshme të cilat në mënyrë të arsyeshme sigurojnë se shpenzimet e telefonisë realizohen në bazë të limiteve të përcaktuara. Kjo rrit rrezikun që fondet publike të shpenzohen në mënyrë jo racionale.

### **Rekomandimi 4**

Rekomandojmë Ministrin e MAPL që të siguroj:

- Forcimin e kontrolleve mbi shpenzimet e telefonit, në mënyrë që ato të jenë në përputhje me kufijtë e përcaktuar; dhe
- Të gjithë zyrtarët që kanë tejkaluar limitet e lejuara, të identifikohen, dhe shumat e mbi shpenzuara pa një arsytim të qartë, t'i kthehen buxhetit të Ministrisë.

### **1.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)**

Buxheti për paga dhe mëditje në MAPL ishte 618,301€ ndërsa sipas shënimeve në P/F në këtë kategori janë shpenzuar 610,831€ ose 99% e buxhetit të aprovuar. Sipas buxhetit final, MAPL ka të punësuar 116 punëtor, prej të cilëve 96 janë punëtor të rregullt, ndërsa 20 janë punëtor që paguhet prej fondit kontingjent si ekupe përgatitore të Komunave të reja.

Rregullorja nr. 2001/36 mbi shërbimin civil përcakton se menaxhimi i dosjeve të personelit kërkon azhurnimin e tyre me kohë, duke bërë plotësimin e dokumenteve të nevojshme.

Ne kemi vërejtur se dosjet e personelit në 10 raste nuk janë azhurnuara mirë dhe të renditura dhe zyrtarët e MAPL-së nuk nënshkruhen në listat e pagave mujore.

## **Konkluzion**

Azhurnimi jo i duhur i dosjeve të punëtorëve, listat e pagave të pa nënshkruara nga zyrtarët, paraqesin disa nga mangësitë e kontrollit të brendshëm në menaxhimin e burimeve njerëzore.

### **Rekomandimi 5**

Rekomandojmë Ministrin e MAPL që të siguroj

- Mirëmbajtje dhe azhurnim të vazhdueshëm të dosjeve të personelit me të gjitha informatat dhe ndryshimet, si dhe listat e pagave të nënshkruhen nga secili zyrtarë i Ministrisë.

## 1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti për kategorinë e subvencioneve ishte 437,249€ ndërsa sipas shënimeve në PVF, nga kjo kategori janë shpenzuar 391,406€ ose 90%.

Përdorimi i Kategorisë së Subvencioneve në MAPL nuk ka transparencë të mjaftueshme. Subvencionet që i paguhen një njësie të përcaktuar apo një ndërmarrje private duhet të bazohet në një marrëveshje zyrtare ndërmjet organizatës buxhetore dhe pranuesit të subvencionit. Gjatë testimit të kësaj kategori kemi vërejtur:

### Pagesa e projekteve nga kategoria e Subvencioneve

Në një rast, me një vendim të Sekretarit të përhershëm të datës 23.10.2010 janë ndarë mjete në vlerë prej 30,000€ për projektin e mbikëqyrjes profesionale, projektim dhe revidim të projekteve në MAPL. Një ndarje e tillë e mjeteve nuk mund të klasifikohet si subvencion.

### **Konkluzion**

Ne konkludojmë që edhe përkundër rekomandimeve tona në vitet e kaluara, MAPL nuk ka arritur të vendosë kontrolle të mira në menaxhimin e subvencioneve.

Mos aplikimi i procedurave të qarta dhe kriterëve të caktuara e rrit dyshimin se shpenzimet janë në harmoni me rregullat financiare për shfrytëzimin e kategorisë së subvencioneve.

### **Rekomandimi 6**

Rekomandojmë Ministrin e MAPL që të siguroj :

- Hartimin e një kornize juridike, duke i specifikuar qartë të gjitha kriteret mbi ndarjen e subvencioneve.

## VI.2 Pasuritë dhe Borxhet

### 2.1 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale

Menaxhmenti i MAPL nuk ishte në gjendje të ofroj ndonjë dëshmi të saktë mbi numrimin fizik të mjeteve më 31 Dhjetor 2010. Si pasojë e kësaj nuk ishte e mundur të bënim një verifikim të të dhënave në kontabilitet me të dhënat e numërimit fizik. Kemi vërejtur se MAPL ka formuar komisionin për regjistrim dhe inventarizim të pasurive me datë 14.02.2011, por akoma nuk është përfunduar raporti për inventarizim të pasurisë.

MAPL, kishte regjistruar në SIMFK si pasuri të vetën, të gjitha projektet e investimeve kapitale që ka financuar Komunitat. Por, pas finalizimit të këtyre projekteve, i ka dërguar kërkesë Thesarit për bartjen e këtyre pasurive në Komunitat përkatëse.

## **Konkluzioni**

MAPL nuk ka kontrolle të përshtatshme mbi menaxhimin efektiv të pasurive të veta. Gjithashtu, mungesa e një regjistri të saktë dhe të plotë mbi të dhënat e pasurisë, i bën të pamundur menaxhmentit të Ministrisë të pasurit e një pasqyre reale mbi pasuritë dhe aplikimin e kontrolleve adekuate.

### **Rekomandimi 7**

Rekomandojmë Ministrin e MAPL që të siguroj :

- Një regjistër gjithë përfshirës të pronës, objekteve dhe pajisjeve si dhe të njëjtat të regjistroj dhe të shpalos në pasqyrat financiare; dhe
- Numërimin e rregullt fizik për tu siguruar mbi ekzistencën e pasurive si dhe të bëj barazimin e rezultateve të numërimit me të dhënat kontabël dhe regjistrin e pasurisë.

## **VII.Kontrolli mbi menaxhimin**

### **VII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm**

Kapitujt e përshkruar më lart flasin për disa dobësi evidente të kontrollit të brendshëm të MAPL. Mangësit, vërehen duke filluar nga raportimi/hartimi i pasqyrave cilësore financiare, shkalla e ultë e ekzekutimit të buxhetit, shpenzimi i pa kontrolluar i telefonave, dhënia e subvencioneve e deri te menaxhimi i dobët i pasurive.

## **Konkluzioni**

Kontrollet e brendshme aktuale të MAPL nuk ofrojnë siguri të mjaftueshme për parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e gabimeve dhe parregullsive të organizatës.

### **Rekomandimi 8**

Rekomandojmë Ministrin e MAPL që të siguroj:

- Rishikimin funksional të procedurave administrative dhe kontrollit të brendshëm, duke analizuar nëse dizajni dhe implementimi aktual janë të përshtatshme. Aty ku janë identifikuar dështimet, kontrollet duhet forcuar apo duhet propozuar masa të reja që ato të jenë plotësisht efektive dhe në pajtim me objektivat e vendosura; dhe
- Zyrtarëve të cilët kanë mangësi të njohurive në fushat e caktuara, duhet mundësuar trajnime shtesë për ngritjen e kapaciteteve.

## VII.2 Auditimi i Brendshëm

MAPL ka të themeluar Njab që përbehet nga Drejtor i Auditimit të Brendshëm dhe një zyrtar. NJAB ka përgatitur një plan vjetor të auditimit, duke paraparë që të realizohen tetë auditime. Gjatë vitit NJAB kishte arritur t'i kryej pesë raporte: dy raporte sipas planit vjetor dhe tri raporte me kërkesë të Ministrit dhe Sekretarit të përhershëm. Pra, siç shihet, kjo njësi nuk kishte përmbushur plotësisht planin vjetor të auditimit.

Auditimi i brendshëm ishte fokusuar më shumë në mbulimin e periudhës financiare të vitit 2009. Kjo nuk është konsistente me konceptin dhe natyrën e auditimit të brendshëm, si një shërbim për të dhënë sugjerime rreth zhvillimit sa më cilësor të aktiviteteve operative dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kontrollit të brendshëm.

Po ashtu, gjetjet dhe rekomandimet e NJAB nuk adresohen si duhet. Ne nuk kemi vërejtur të ketë ndonjë plan veprimi për zbatimin e tyre nga departamentet përkatëse.

MAPL ka formuar komitetin e auditimit më 31.01.2011, në përbërje prej 3 (tre) anëtarësh.

### Konkluzioni

„Në vitin 2010 Njab ka dështuar në përmbushjen e rolit si një sigures i implementimit të kontroleve të brendshme. Vërehet mungesë e veprimeve të menaxhmentit lidhur me rekomandimet e auditimit të brendshëm. Po ashtu mungesa e një komiteti të auditimit mund të jetë shpjegim i veprimeve të kufizuara lidhur me rekomandimet e auditimit të jashtëm.

#### **Rekomandimi 9**

Rekomandojmë Ministrin e MAPL që të siguroj:

- NJAB, gjatë përgatitjes së planit vjetor të auditimit, më shumë të fokusohet në proceset dhe aktivitetet e vitit aktual; ,
- Rekomandimet e NJAB të adresohen nga menaxhmenti me plane konkrete të veprimit nga departamentet përkatëse; dhe
- Fuqizimin e Komitetit të auditimit për mbikëqyrjen e duhur të planeve dhe rezultateve të auditimit.

## VIII. Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e MAPL

### Konkluzionet e përgjithshme

Konkluzioni ynë është se menaxhimi financiar dhe kontrollet në MAPL në përgjithësi funksionojnë mirë, mirëpo ende ka disa dobësi të cilat duhet të përmirësohen. Shkalla e ekzekutimit të buxhetit vetëm prej 87% është një indikator se MAPL duhet dukshëm t'i përmirësoj politikat buxhetore. Edhe këtë vit MAPL nuk ishte në gjendje të hartoj PVF plotësisht sipas kornizës ligjore. Problemi i regjistrimit dhe shpalosjes së plotë të pasurive, po ashtu përcillet nga viti në vit. MAPL akoma nuk i ka dhënë hapësirë të merituar auditimit të brendshëm, i cili mendojmë se do t'i ndihmonte shumë në përmirësimin dhe vendosjen e kontrolleve të duhura.

Sidoqoftë, në krahasim me vitin e kaluar ne kemi vërejtur një progres të mirë. MAPL duhet të bëj përpjekje të mëtutjeshme që të eliminoj dobësitë dhe mangësitë e identifikuara me këtë raport.

### **Rekomandimi i përgjithshëm**

Ne rekomandojmë Ministrin e MAPL që të rishikoj dhe të analizoj me kujdes fushat me mangësi të theksuara në këtë raport dhe të ndërmerre veprimet e duhura, siç është thënë përmes rekomandimeve .



## Shtojca I. Komentet e MAPL-së dhe përgjigjja e ZAP-it

Menaxhmenti i Ministrisë i ka pranuar të gjitha të gjeturat dhe konkluzionet tona të paraqitura në raportin e auditimit mbi pasqyrat financiare për vitin 2010 dhe është zotuar që do ti bëjë përpjekjet për t'i adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

## Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit

(e shkëputur nga ISSAI 400)

**9.** Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

**10. Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- (d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

**11. Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

**12.** Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- (a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

**13. Opinion i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar.

I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

**14. Opinion i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

**15. Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

**16.** Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.